



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranimi - Prilbena Me Data 27.12.2024			
Nr. Llogaritsh Org. Breg.	Nr. Komisioni	Shifra e Prilbës	Vlera Vendnost
01 -	110/05 -	1499	



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë në bazë të nenit 12, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 18 të Ligjit për Dhënien e Pronës së Palujtshme të Komunës në Shfrytëzim Nr.06/L-092, nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d, neni 40, 41, shkronja a të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, në mbledhjen e mbajtur më datën 26.12.2024 miraton këtë:

## V E N D I M

**për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për dhënien e pronës së komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë**

### Neni 1

Me këtë Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për shqyrtimin e ankesave për dhënien e pronës së komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë në Komunën e Vitisë.

Komisioni propozohet prej 5 anëtarëve, dy nga ekzekutivi, dy kuvendi i komunës dhe një nga shoqëria civile dhe atë:

- Rexhep Osmani - anëtar i komisionit - përfaqësues i ekzekutivit të komunës.
- Hamide Ymeri - anëtare e komisionit - përfaqësuese e ekzekutivit të Komunës
- Reshat Azizi - përfaqësues i kuvendit të komunës
- Sejdi Emini - përfaqësues i kuvendit të komunës
- Lorena Sahiti - përfaqësuese e sektorit jo qeveritar.

### Neni 2

Me këtë vendim detyrat e komisionit nga neni 1 i këtij vendimi janë përcaktuar në Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës Nr.06/L-092 i Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës me Nr.10, të datës 03.04.2019) dhe Rregullorja (QRK) 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së palujtshme të komunës. Shqyrtimi i të gjitha ankesave të paraqitura, kthimi i përgjigjeve brenda afatit ligjorë, nxjerrja e vendimit lidhur me ankesat dhe raportimi.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisioni dhe Zyra e Prokurimit në Komunën e Vitisë.

### Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Anëtarve të komisionit;
3. MAPL-së; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË  
KRYESUESI

Bekim Azizi

